



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:269053

Datë: 22.02.2023

Numri i dokumentit: 04000953

A-REV.nr. 1/2023

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Beshir Islami dhe Rrustem Thaqi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit A. H. nga F., kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, (KPM SHCK), me bazë juridike anulim i aktit administrativ të organit të paditur, duke vendosur sipas revizionit të paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.362/2022 të datës 22.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 21 Shkurt 2023, merr;

A K T V E N D I M

Hudhet poshtë si i palejuar revizioni i parashtruar nga paditësi, A.H., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë AA.nr.362/2022, të datës 22.11.2022.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë AA. nr.362/2022, të datës 22.11. 2022, në pikën I. të dispozitivit, Aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, (KPM SHCK), e datës 21.04.2022. Në pikën II. Ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A nr. 478/18, i datës 08.03.2022. Në pikën III. Refuzohet si e pa bazuar kërkesë padia e paditësit A. H. nga F. me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurit KPM SHCK, A nr. 2/2018, i datës 28.02.2018, dhe vendimi i Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës nr. Ref. 01225/17ak, i dt. 28.12.2017, dhe të detyrohet i padituri KPM SHCK që ta prishë vendimin e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës , po ashtu të paguaj shumën prej 43.5 Euro, për muajt Shtator, Tetor ,Nëntor, Dhjetor të vitit 2017 , 12 muaj të viti 2018, dhe 4 muaj të vitit 2019, dhe pagat përcjellëse për muajin Prill 2019.

Kundër aktgjykimit si më lartë të Gjykatës së Apelit, paditësi në Gjykatë Supreme ka parashtruar revizion, me të cilin e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; shkeljes së dispozitave të Ligjit për Paga të shërbyesve civil të Kosovës nr. 03/L147, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Propozon që Gjykata Supreme ta aprovoj revizionin aktgjykimi i kontestuar të prishet dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosi apo të Vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë-departamenti për çështje administrative në Prishtinë, A nr. 478/2018 datë 08.03.2022.

Gjykata Supreme shqyrtoi revizionin e ushtruar në pajtim me nenin 52.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe gjen se;

Revizioni i paraqitur është i palejuar.

Neni 24 të Ligjit për konfliktet administrative (LKA) përcakton se, kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrorë në Gjykatë Supreme të Kosovës, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Kërkesa mund të parashtrorë vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale, ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes.

Neni 25 (LKA) përcakton se, kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës, prokurori publik mund t'i parashtrorë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nëse me vendim të tillë është shkelur ligji, dispozitat e tjera ose akti i përgjithshëm.

Sipas nenit 50 (LKA) kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i dërgohet gjykatës brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën. Ndërsa kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqitet brenda nëntëdhjetë (90), ditëve nga dita kur u është dërguar palëve vendimi, kundër të cilit paraqitet kërkesa.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe dispozitave të cekura të Ligjit për Konflikte Administrative kjo gjykatë gjen se, kundër vendimeve të formës së prerë për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrorë në Gjykatë Supreme kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ndërsa prokurori publik kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Nga theksimet si më lartë rezulton se me revizion nuk mund të kontestohen vendimet e formës së prerë të departamentit për çështje administrative të gjykatës së shkallës së dytë, prandaj kjo gjykatë e hedhë poshtë revizionin e paditësit, si të palejuar.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 52.1, lidhur me nenin 24 dhe 25, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME – PRISHTINË
A.REV. nr. 1/2023, datë 21 shkurt 2023

Procesmbajtës,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani